

UDHËZIM
Nr.30, datë 12.5.2009

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.17, DATË 13.5.2008 “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ministri i Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.17, datë 13.5.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet, si më poshtë:

Në pikën 1.3.2 shprehja “në degën e tatimeve” zëvendësohet me shprehjen “në Drejtorinë Rajonale Tatimore”.

Në pikën 2.2.1 paragrafi i fundit, pas fjalës së fundit pasiv, shtohet fjalia “sipas nenit 44 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH””.

Në pikën 2.2.2 në rreshtin e fundit, shprehja “këto detyrime parashkruhen sipas nenit 46.2 të ligjit “Për procedurat tatimore” ndryshohet me shprehjen “këto detyrime parashkruhen sipas nenit 100 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

Në pikën 7.1 paragrafi i fundit, shprehja “në pikën 10.1 të këtij udhëzimi” ndryshohet me shprehjen “në pikën 14.1 të këtij udhëzimi”.

Në pikën 7.1 në rreshtin e fundit, shprehja “sipas paragrafit 15.1.4 të këtij udhëzimi” ndryshohet me shprehjen “sipas paragrafit 19.2 të këtij udhëzimi”.

Pas pikës 8.1.2 shtohet pika 8.1.3 me këtë përmbajtje:

Pika 8.1.3 “Furnizimi i dhënies me qira të ndërtesave”

“Pavarësisht nga përjashtimet e parashikuara në nenin 20 të ligjit nr.7928 datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, personi i tatueshëm gëzon të drejtën që në bazë të kërkesës së tij pranë organit tatimor, dhënia me qira e ndërtesave që ai furnizon, sipas pikës 3 të këtij neni, të mos trajtohet si furnizim i përjashtuar, por të konsiderohet furnizim i tatueshëm, sipas nenit 16 të ligjit “Për TVSH-në”. Në këto raste, subjekti furnizues depoziton një kërkesë me shkrim pranë drejtorisë rajonale tatimore ku është i regjistruar, duke specifikuar edhe të dhënat e qiramarrësit (emri, nipt-i, adresa).

Në fund të pikës 8.12, shtohen dy paragrafë si më poshtë:

-importimi i mjeteve, të cilat ndihmojnë në integrimin në jetë të invalidëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfshirë këtu edhe autovetura të përshtatura për përdorim prej tyre;

- importimi i anijeve, sipas nënkrerëve 8901 20, 8901 30, 8901 90, 8902 00 të nomenklaturës së kombinuar të mallrave.

Në pikën 19 fjalia e fundit ndryshohet nga “pikën 15.1.1. më poshtë “në “pikën 19.1. më poshtë”

Në pikën 20, paragrafi 2 shprehja “Udhëzimit nr.3, datë 30.1.2006” ndryshohet “udhëzimit nr.17, datë 13.5.2008”.

Në pikën 20.1.1, germa c shfuqizohet.

Germa ç e kësaj pike ndryshohet si më poshtë:

“nuk kanë asnjë vlerësim tatimor nga ku të kenë rezultuar detyrime tatimore sipas metodave alternative, që përcaktohet në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

Në pikën 20.1.2 germa c shfuqizohet.

Germa ç e kësaj pike ndryshohet si më poshtë:

“nuk kanë asnjë vlerësim tatimor nga ku të kenë rezultuar detyrime tatimore sipas

metodave alternative, që përcaktohet në ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

Në pikën 20.2 pika c fjalë e fundit me përmbajtje “Në të gjitha këto raste rimbursimi bëhet siç përcaktohet në pikën 16 më lart të këtij udhëzimi”, shfuqizohet.

Në pikën 21, në fund të tij shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

Në mungesë të emërimit të një përfaqësuesi tatimor, të gjitha detyrimet dhe penalitetet për to paguhen nga përfituesi vendas i furnizimit, në përputhje me ligjin 10 003, datë 6.10.2008.

Në pikën 23 fjala “Interesat” zëvendësohet me fjalën “Kamatëvonesa” dhe paragrafi i parë i kësaj pike ndryshohet si më poshtë:

“Kur një person i tatueshëm nuk paguan shumën e plotë të TVSH-së së detyrueshme brenda datës së përcaktuar në ligj, detyrohet të paguajë kamatëvonesa, sipas përcaktimeve të nenit 76 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

Paragrafi i dytë i pikës 23 ndryshohet si më poshtë:

Kamatëvonesat për mosrimbursim në kohë janë të zbatueshme, kur:

Organet tatimore nuk bëjnë rimbursimin e TVSH-së për një person, në bazë të nenit 50 të ligjit “Për TVSH-në” brenda 30 ditëve kalendrike nga data e paraqitjes së kërkesës, si dhe në një nga format e përcaktuara në nenin 75 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”. Në këtë rast ato detyrohen të paguajnë interesa siç përcaktohet në nenin 76 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

Në pikën 24 paragrafi i fundit ndryshohet nga “sipas neneve 45 e 46 të ligjit “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” në “sipas kreut XI të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE

Ridvan Bode